



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit anonim për korrupsion, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, morri

## VENDIM

Procedura për lëndën numër 12-2397 nga viti 2019, e formuar pas denoncimit anonim nr. 12-2397/1 me datë 12.04.2019, dorëzuar nga parashtrues i panjohur, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndës, në rastin e lëndës është vepruar nga organe kompetente, dhe njëherit edhe KSHPK formoi lëndë në Njësinë për hulumtim të gjendjes së pronës për të cilën procedura ende vazhdon.

Lënda me numër 12-2397 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin – në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

## Sqarim

Lënda me numër 2397 nga viti 2019 është formuar pas denoncimit me numër 12-2397/1 me datë 12.04.2019, dorëzuar deri në Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtrues i panjohur – denoncim anonim.

Në denoncim tregohet për akuzat kundër Drejtorit gjeneral të Kombinatit të Duhanit SHA Prilep, përshkak të mosparaqitjes së pronës në listën e anketës dhe me akuzat për dyshime për aktivitete joligjor të kryera nga ana e tij dhe thyrje të procedurës gjatë furnizimit në kombinat. Për denoncimin është bashkangjitur edhe plotësimi me numër 12-2397/5 me datë 12.09.2019 me të cilën janë dorëzuar informacione shtesë në lidhje me rastin e lëndës.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) i merr parasysh të gjitha akuzat e parashtruesit dhe me qëllim të caktimit të gjendjes faktike të plotë për rastin e denoncuar KSHPK dorëzoi kërkesë për të dhëna dhe informacione deri në Kombinatit të Duhanit SHA Prilep.

Nga procedura e bërë për caktimin e gjendjes faktike, KSHPK e konstatoi, me sa vijon:

- Në rastin e lëndës bëhet fjalë për akuzat kundër personit ..... , Drejtor gjeneral i Kombinatit të Duhanit SHA Prilep, për shkak të mosparaqitjes së pronës në listën anketuese dhe për dyshime për aktivitetet joligjore të kryera nga ana e tij në bazë të shkeljes së procedurës për furnizime në kombinat. Në denoncimin e dorëzuar theksohet se edhe në lidhje me akuzat e lëndës në iniciativë të Bordit të drejtorëve është angazhuar Shërbimi për revizion të brendshëm i cili duhet të bënë kontrollim të akuzave dhe të përgadisë Raport nga revizionin i bërë të cilin

- do ta dërgon deri në Bordin e drejtorëve, por e njëjta ende nuk është bërë dhe parashtruesi i denoncimit dyshon se drejtori ka qenë në koordinim me shërbimin për revizion.
- Në lidhje me akuzat e deoncimit anonim të cilat kanë të bëjnë me mosparaqitjen e pronës në listën anketuese të drejtorit gjeneral të Kombinatit të Duhanit SHA Prilep, KSHPK në senacën s 17-të të mbajtur me datë 22.05.2019 morri përfundim që të hapet lëndë në Njësinë për hulumtim të gjendjes së pronës, për arsye të kontrollimit të rastit të lëndës, me çka është formuar lënda me numër 08-3192/1 me datë 19/06/2019. Kjo lëndë më vonë është bashkangjitur me lëndën 08-2396 nga viti 2019, me arsye se bëhet fjalë për lëndë që kanë të bëjnë me personin e njëjtë dhe me gjendjen faktike të njëjtë, përshkak të veprimit dhe përfundimit të KSHPK në procedurën e vetmem pas të cilës procedura ende është në vazhdim dhe është në fazën e mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave nga organet kompetente.
  - Me datë 03.07.2019, me kërkesë të KSHPK është dorëzuar lajmërim nga ana e Kombinatit të Duhanit SHA Prilep, me shtojcë kopje të raportit të revizionit përgaditur nga Shërbimi për revizion të brendshëm pran Kombinatit të Duhanit SHA Prilep, me të cilën informohet për këtë:
    - o Në seancën e Bordit të drejtorëve në Kombinatit të Duhanit SHA Prilep e cila është mbajtur me datë 06.12.2018, është marrë përfundim për veprim nga Shërbimi të brendshëm për revizion dhe iu është dhënë kahje për veprim, me caktimin e afatit në të cilin duhet të përgaditet dhe të dorëzohet raport të shkruar për gjendjen e konstatuar.
    - o Me datë 11.03.2019, Bordi i drejtorëve morri Vendim për ndryshime të Përfundimin me datë 06.12.2018, me të cilin vendim vazhdohet afati për përgaditje dhe dorëzim të revizionit të bërë nga Shërbimi për revizion të brendshëm dhe atë më së voni deri me 10.04.2019, kurse shtyrja e afatit është bërë përshkak të numrit të madhë të lëndëve të veçanta dhe sasisë së materialit i cili duhet të jetë lëndë të revizionit. Njëherit, Shërbimi të brendshëm për revizion është obliguar nga anëtarën e Bordit të drejtorëve që në mënyrë elektroniket'i dorëzon raportet për revizionin e bërë në etapa ashtu siç i përgaditë sipas pikave të caktuar.
    - o Raportet për revizionet e bëra nga ana e Udhëheqësit të Shërbimit të brendshëm për revizion janë dorëzuar deri te anëtarët e Bordit të drejtorëve në përputhje me dinamikën e përgaditjes së tyre, kurse me datë 21.05.2019 si pikë e rendit të ditës në seancës e Bordit të drejtorëve është vendosur edhe raportet nga revizioni i jashtëzakonshëm i bërë nga Shërbimi i brendshëm për revizion të cilët janë rishikuar dhe diskutuar një nga një nëpër pika e caktuara.
    - o Në bazë të raporteve të dorëzuara nga ana e Shërbimit të brendshëm për revizion, si dhe diskutimet e bëra në seancën e Bordit të drejtorëve lidhur me këtë temë, në iniciativë nga pjesë e anëtarëve joekzekutiv, Bordi i drejtorëve në disa seanca të njëpasnjëshme morri përfundim, dhe atë:
      - Në seancën e Bordit të drejtorëve të mbajtur me datë 21.05.2019, është dhënë prozim për ndryshime të dispozitave në Statusin e shoqërisë, të cilat kanë të bëjnë me autorizimet e Drejtorit gjeneral ekzekutiv dhe për atë zvogëlim të autorizimeve nga 50000 euro në 30000 euro. Me këtë njëherit Statusi si akt më i lartë është përputhur me Procedurën për shitje të sasive të panevojshme dhe mjeteve themelore në Kombinatin e Duhanit SHA Prilep dhe Procedura për furnizime të mallrave dhe shërbimeve në Kombinatin e Duhanit SHA Prilep të miratuara me datë 19.10.2018. Ndryshimet dhe plotësimet në Statusin janë

miratuar dhe vendosur në Kuvendin vjetor të akcionerëve të Kombinatit të Duhanit SHA Prilep me datë 28.06.2019.

- Në seancën e Bordit të drejtorëve të mbajtur me datë 06.06.2019 janë marrë disa përfundime dhe atë: anëtarët ekzekutiv të Bordit të drejtorëve në kohë të dorëzojnë raporte tremujore për punën në përputhje me rregullat ligjore dhe dispozitat e statusit, në të cilën mënyrë anëtarët joekzekutiv nga Bordi i drejtorëve do të kishin informacione precize dhe në kohë për punën e shoqërisë: detyrohet Shërbimi për shitje dhe bashkëpunim me shërbimin juridik dhe Shërbimi i brendshëm për revizion të përgadit propozim-ndryshime dhe plotësime në Procedurën për shitje të sasive të panevojshme dhe mjete themelore në Kombinatit të Duhanit SHA Prilep dhe Procedura për furnizime të mallrave dhe shërbimeve në Kombinatit të Duhanit SHA Prilep.

Bordi i drejtorëve ka dhënë sugjestion dhe rekomandim që ndryshimet në procedurat për furnizime dhe shitje të mallrave dhe shërbimeve në drejtim: rritje në minimum të ofertave prej 3 në 5 në kushte kur natyra e furnizimit e lejon këtë, Kufizim dhe mbrojtje në ofertat e subjekteve të lidhura me qëllim që të fitohet konkurrencë e oferave dhe çmime më të ulëta dhe Lajmërim me shkrim në kohë deri në Bordin e drejtorëve për çdo furnizim e cila në përputhje me procedurën është nën kompetencë të Drejtorit gjeneral ekzekutiv, por ka elemente për furnizim suksesiv.

Në seancat e mbajtura të Bordit të drejtorëve lidhur me këtë temë, janë dhënë edhe kahjet fillestare për deekipik kadrovik të Shërbimit të brendshëm për revizion, si dhe nevojë për rregullim më të mirë të shfrytëzimit të shërbimeve të avokatëve nëpërmjet procedurave dhe raporteve të rregullta për shërbimet e bëra me specifikimi detal të të njëjtës, kurse në seancat e ardhshme të Bordit të drejtorëve do të pasojnë edhe përfundime konkrete për këto pika.

Në lidhje me gjendejen faktike të caktuar, KSHPK konstaton se në lidhje me akuzat e lëndës për dyshime për aktivitete joligjore dhe shkelje të procedurave gjatë furnizimeve në kombinat, është vepruar nga ana e Shërbimit për revizion të brendshme cila ka bërë revizion në shoqatën aksionare të theksuar, raportet për revizionet e bëra janë dorëzuar deri tek anëtarët e Bordit të drejtorëve në përputhje me dinamikën e përgaditjes së tyre, kurse nga ana e Bordit të drejtorëve të shoqatës aksionare të përmendur janë marrë përfundime në lidhje me gjendjet e konstatuara gjatë revizionit dhe se do të pasojnë edhe përfundime tjera konkrete. Në lidhje me akuzat e denoncuar të lëndës të cilat kanë të bëjnë me mosparaqitjen e pronës në listën anketuese të drejtorit gjeneral të Kombinatit të Duhanit SHA Prilep, KSHPK në seancën s e 17-të të mbajtur me datë 22/05/2019 ka marrë përfundim që të hapet lëndë në Njësinë për hulumtim të gjendjes së pronës, për shkak të kontrollimit të akuzave të lëndës, dhe pas të cilës lëndë procedura ende është në vazhdim dhe është në fazë të mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave nga organet kompetente.

Duke pasë parasyshë të konstatuarën, Komisioni shtetëror vlerësoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për veprim në këtë lëndë, procedura për të njëjtë të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke marrё paarsyshё tё gjithё tё shёnuarёn mё sipёr, Komisioni shtetёrir pёr parandalim tё korrupsionit vendosi si nё dispozitё tё kёtij vendimi.

**Ёshtё vendosur me datё 11 Dhjertor tё viti 2020, me numёr 12-2397/6**

Dorёzuar deri tek: arkiva  
Pas pёrfundimit tё KSHPK  
Punoi: J. C., kёshilltarё  
Miratoi: m-r V. G., anёtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETЃOROR PЃR  
PARANDALIM TЃ KОРРУПСИОНИТ  
Kyetar: Biljana Ivanovska